

# KARTËMONEDHA 2000 LEKË

## KONTROLLO VËRTETËSINË E KARTËMONEDHËS

### PREK

Kjo kartëmonedhë është shtypur në letër prej pambuku dhe karakterizohet nga një tingëllim e konsistencë e veçantë.

**1** Ndieje shtypin e ngritur te vlera nominale, tekstet dhe portreti. Ndiej vijat e shkurtra përgjatë anës së majtë dhe të djathtë të kartëmonedhës, që përbëjnë elementin e njohjes nga personat me aftësi të kufizuara shikimi.

### SHIKO

**2** Portreti i Mbretit Gent, vlera nominale 2000 Lekë dhe simboli i stilizuar i shqiponjës bëhen të dukshme, kundrejt dritës.

**3** Nga një shirit i ndërprerë, filli i sigurisë duket një vijë e errët e pandërprerë.


### LËVIZ

**4** Shiriti i argjendtë në të majtë, shfaq logon e Bankës së Shqipërisë, portretin e Mbretit Gent, vlerën nominale 2000 Lekë dhe lulet Gentiana, të shoqëruar me efekte të ndryshme optike.

**5** Monedhat e Mbretit Gent në cepin e sipërm djathtas ndryshojnë ngjyrë, nga e artë në të gjelbër, me një efekt dinamik lart e poshtë.

**6** Filli i sigurisë ndryshon ngjyrë nga e gjelbër në të purpurt.

**7** Në faqen e pasme të kartëmonedhës, shiriti i shndritshëm në zonën qendrore shfaq të shkruar vlerën 2000 Lekë.



## KARTËMONEDHA JONË E RE: E SIGURT DHE MODERNE

Banka e Shqipërisë vijon ta plotësojë serinë e re të kartëmonedhave shqiptare, me emetimin e prerjeve të reja me pamje e cilësi të përmirësuar, për t'iu përshtatur zhvillimeve të teknologjisë, duke i bërë ato më të sigurta dhe të besueshme për publikun.

Kartëmonedhat ekzistuese do të vijojnë të përdoren si mjet pagese bashkë me kartëmonedhat e reja.



Për më shumë informacion, vizito [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)